

32006D0144

2006/144/KE Vendim i Këshillit, datë 20 shkurt 2006, për orientimet strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (periudha e programimit 2007-2013)

Gazeta Zyrtare L 055, 25/02/2006, fq. 0020 - 0029

Vendim i Këshillit, datë 20 shkurt 2006, për orientimet strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (periudha e programimit 2007-2013)

(2006/144/KE)

KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) 1698/2005, datë 20 shtator 2005, për mbështetjen e zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor European për Zhvillimin Rural (FBEZHR) [1] dhe në veçanti, neni 9 pika 2, fjalia e parë, e saj,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit European [2],

Duke pasur parasysh se:

(1) Neni 9 pika 1 i Rregullores nr. 1698/2005 parashikon që orientimet strategjike për zhvillimin rural për periudhën e programimit nga data 1 janar 2007 deri më datë 31 dhjetor 2013 duhet të miratohen në nivel komunitar, në mënyrë që të përcaktohen prioritetet e zhvillimit rural.

(2) Këto orientime strategjike duhet të reflektojnë rolin shumëfunksional që luan aktiviteti fermer në pasurimin dhe shumëllojshmërinë e peizazhit, produkteve ushqimore dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore në të gjithë Komunitetin.

(3) Këto orientime strategjike duhet të identifikojnë zonat më të rëndësishme për të realizuar prioritetet e Komunitetit, në veçanti në lidhje me qëllimet e Goteborgut për qëndrueshmërinë dhe strategjisë së re të Lisbonës për rritjen dhe punësimin, krijuar nga Këshillat Europeanë të Goteborgut (15 dhe 16 qershor 2001) dhe të Selanikut (20 dhe 21 qershor 2003) përkatësisht.

(4) Në bazë të këtyre orientimeve strategjike çdo anëtar i BE-së, duhet të përgatisë planin strategjik kombëtar të tij si kuadër referencë për përgatitjen e programit të zhvillimit rural,

KA VENDOSUR SI MË POSHTË:

Nen i vetëm

Orientimet strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (periudha e programimit 2007-2013) siç përcaktohet në shtojcë, miratohen si më poshtë.

Nënshkruar në Bruksel, më 20 shkurt 2006.

Për Këshillin

Presidenti

J. Proll

[1] GZ L 277 21.10.2005, fq.1.

[2] I papublikuar ende në Gazetën Zyrtare.

SHTOJCË

Orientimet strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural (periudha e programimit 2007-2013)

1. Parathënie

Rregullorja 1698/2005 përcakton qëllimin dhe fushën e zbatimit të asistencës nga FBEZHR-ja. Orientimet strategjike të Komunitetit identifikojnë brenda këtij kuadri fushat e rëndësishme për realizimin e prioriteteve të Komunitetit, në veçanti, në lidhje me qëllimet e Goteborgut, për qëndrueshmërinë dhe në strategjinë e re të Lisbonës për rritje dhe punësim.

Orientimet strategjike të Komunitetit për zhvillimin rural do të ndimojnë për;

- identifikimin dhe rënien dakord mbi zonat ku mbështetja e BE-së për zhvillimin rural krijon më shumë vlerë të shtuar në nivelin e BE-së,
- krijimin e lidhjes me prioritetet kryesore europiane (të Lisbonës dhe Goteborgut) duke i përkthyer ato në politika të zhvillimit rural,
- sigurimin e qëndrueshmërinë me politikat e tjera europiane, në veçanti në fushat e kohezionit dhe mjedisit,
- shoqërimin e zbatimit të politikës së re të përbashkët bujqësore me orientim nga tregu (PPB) dhe risukturimin e nevojshëm që do të sjellë për Shtetet Anëtare të reja dhe të vjetra.

2. Zhvillimi Rural dhe qëllimet e përgjithshme të Komunitetit

2.1. Politika e Përbashkët Bujqësore dhe zhvillimi rural

Bujqësia vazhdon të jetë përdoruesi më i madh i tokës rurale, si dhe faktori kryesor i cilësisë së fshatit dhe mjedisit. Rëndësia dhe lidhja e Politikës së Përbashkët Bujqësore me zhvillimin rural janë rritur me zgjerimin e fundit të Bashkimit Europian.

Pa dy shtyllat e Politikës së Përbashkët Bujqësore, politikat e tregut dhe të zhvillimit rural, shumë zona rurale në Europë do të përballëshin me probleme në rritje ekonomike, sociale dhe mjedisore. Modeli europian i bujqësisë

reflekton rolin shumëfunktional të aktivitetit fermer në pasurimin dhe shumëllojshmërinë e peizazhit, produkteve ushqimore dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore [1].

Parimet orientuese të Politikës së Përbashkët Bujqësore, politikave të tregut dhe zhvillimit rural u përcaktuan në Këshillin European të Goteborgut (15 dhe 16 qershor 2001). Sipas përfundimeve të tij, performanca e lartë ekonomike duhet të shkojë krah për krah me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe niveleve të mbetjeve, mirëmbajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, ruajtjes e ekosistemeve dhe shmangien e shkretimit. Për t'u përballur me këto sfida, Politika e Përbashkët Bujqësore dhe zhvillimi i ardhshëm i saj, ndër objektivat e saj, duhet të kontribuojë në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur theksin në inkurajimin e produkteve të shëndetshme dhe me cilësi të lartë, metodave të prodhimit të qëndrueshme për ambjentin, duke përfshirë prodhimin organik, lëndët e para të ripërtëritshme dhe mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike.

Parimet orientuese kryesore u konfirmuan në përfundimet e strategjisë së Lisbonës, të Këshillit të Selanikut (20 dhe 21 qeshor 2003). Reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore dhe zhvillimi rural mund të japë një kontribut kryesor në konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vitet në vazhdim.

2.2 Drejt një bujqësie të qëndrueshme: reformat e viteve 2003-2004

Reformat e viteve 2003-2004 të Politikës së Përbashkët Bujqësore përbëjnë një hap të madh përpara në përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues të aktivitetit fermer në BE, dhe ngritjen e kuadrit për reformat e ardhshme. Reformat pasuese kanë kontribuar në konkurrueshmërinë e bujqësisë europiane duke ulur garancitë e mbështetjes së çmimeve dhe inkurajuar rregullimet strukturale. Paraqitja e pagesave të drejtpërdrejta të ndara inkurajon fermerët t'i përgjigjen sinjaleve të tregut të prodhuara nga kërkesat e konsumatorëve në vend të lehtësive që ofrojnë politikën e lidhura me sasinë. Përfshirja e standardeve mjedisore, të sigurisë ushqimore, të shëndetit të kafshëve dhe të mirëqenies së ndërpraktueshme me njëra tjetrën forcojnë besimin e konsumatorit dhe rritin qëndrueshmërinë mjedisore të aktivitetit fermer.

2.3. Zhvillimi rural 2007 deri në 2013

Politika e zhvillimit rural e të ardhmes përqendrohet në tri fusha kryesore: ekonominë agrourbore, mjedisin si dhe në ekonominë rurale dhe popullsinë e gjerë. Brezi i ri i strategjive dhe programeve të zhvillimit rural do të ndërtohen mbi katër boshte, më saktë: boshti 1, përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorëve të bujqësisë dhe pyjeve; boshti 2, përmirësimi i mjedisit dhe fshatit; boshti 3, cilësia e jetës në zonat rurale dhe diversifikimi i ekonomisë rurale, boshti 4, mbi përvojën "Lider".

Sipas boshtit 1, një gamë masash do të trajtojë kapitalin njerëzor dhe fizik në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe pyjeve (promovimin e transferimit të njohurive dhe novacionit) dhe cilësinë e prodhimit. Boshti 2 parashikon masa për mbrojtjen dhe rritjen e burimeve natyrore, si dhe për ruajtjen e sistemeve të aktivitetit fermer me vlerë të lartë natyrore dhe ato pyjore, dhe peizazhet kulturore të zonave rurale të Europës. Boshti 3 ndimon në zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe kapitalit njerëzor në zonat rurale, për përmirësimin e kushteve për rritjen dhe krijimin e vendeve të punës në të gjithë sektorët dhe diversifikimin e aktiviteteve ekonomike. Boshti 4, bazuar në përvojën "Lider", paraqet mundësitë për qeverisje novatore nëpërmjet qëndrimeve lokale, nga poshtë lart për zhvillimin rural.

2.4 Përballja me sfidat

Zonat rurale karakterizohen nga shumëllojshmëri e gjerë situatash, të cilat variojnë nga zona rurale të largëta, që vuajnë nga shpopullimi, dhe rënia deri në zonat periurbane nën presion në rritje nga qendrat urbane.

Në përputhje me përkufizimin e OBEZH-it që bazohet në dendësinë e popullsisë, zonat rurale [2] zënë rreth 92 % të territorit të BE-së. Për më tepër, 19% e popullsisë jeton zona kryesisht rurale dhe 37 % në zona me tipare të ndjeshme rurale. Këto rajone prodhojnë rreth 45% të Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) në BE, dhe sigurojnë 53% të punësimit, por kanë tendencë të mbeten mbrapa zonave jorurale në lidhje me disa tregues shoqëror-ekonomik, duke përfshirë tregues strukturorë. Në zonat rurale, të ardhurat për frymë janë tri herë më të ulta [3], norma e punësimit të grave është më e ulët, sektorët e shërbimeve janë më të pazhvilluara, niveli i arsimit të lartë është më i ulët dhe përqindja e familjeve me lidhje të shpejtë interneti është më e ulët. Largësia dhe të qenët në periferi janë probleme të mëdha në disa zona rurale. Këto pengesa kanë tendencë të jenë më të theksuara në zonat kryesisht rurale, megjithatë gjendja e përgjithshme në nivel BE-je mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Mungesa e mundësive, kontakteve dhe infrastrukturës trajnuese, janë probleme të veçanta për gratë dhe të rinjtë në zonat e largëta rurale.

Zgjerimi ka ndryshuar hartën bujqësore. Në Shtetet e vjetra Anëtare bujqësia zë 2% të PBB-së, në Shtetet e reja Anëtare zë 3% dhe në Rumani dhe Bullgari zë më shumë se 10%. Në Shtetet e reja Anëtare punësimi në bujqësi është tri herë më i lartë (12%) se sa në Shtetet e vjetra Anëtare (4%). Në Rumani dhe Bullgari niveli i punësimit në bujqësi është relativisht i lartë.

Bashkërisht, sektorët e bujqësisë dhe ushqimit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ekonomisë së BE-së, duke siguruar rreth 15 milion vende pune (8,3% të punësimit në total) dhe 4,4% të PBB-së. Bashkimi Europian është prodhuesi më i madh botëror i ushqimeve dhe pijeve dhe me një prodhim të përbashkët që llogaritet në 675 bilion euro. Megjithatë, sektori mbetet shumë i polarizuar dhe fragmentar nga pikëpamja e madhësisë, me mundësi dhe kërcënime të mëdha për firmat. Pyjet dhe industritë e lidhura me to punësojnë rreth 3,4 milion njerëz dhe xhiro vjetore 350 bilion euro, por vetëm 60% e rritjes vjetore të pyjeve shfrytëzohet aktualisht.

Bujqësia dhe pyjet përfaqësojnë 77% të përdorimit të tokës në BE. Rendimenti mjedisor i bujqësisë në ruajtjen dhe rritjen e burimeve natyrore në vitet e fundit ka qenë e përzier. Në lidhje me cilësinë e ujit, sasia totale e azotit ka rënë pak në Shtetet e vjetra Anëtare të BE-së që nga viti 1990, megjithatë disa vende dhe rajone kanë akoma probleme të ndjeshme me presionin nga kullimi i ushqyeseve. Problemet e emetimit të amoniakut, eurotrofikimit, degradimit të tokës dhe keqësimit të shumëllojshmërisë biologjike vazhdojnë të shfaqen në shumë zona. Megjithatë, ka pasur një rritje të sipërfaqeve bujqësore të përdorura për prodhim organik (5,4 milion hektarë në BE) dhe burime të ripërtëritshme (një përlllogaritje prej 1,4 milion hektarë është përdorur për prodhimin e bioenergjisë në vitin 2004, nga e cila 0,3 milion hektarë sipas primit të bimëve për energji, dhe 0,6 milion hektarë për tokat e lëna mënjane. Tendencat afatgjata në ndryshimin e klimës ndikojnë gjithnjë e më shumë në riformimin e strukturës së aktivitetit fermer dhe atë të pyjeve. Ka pasur përparime në mbrojtjen e shumëllojshmërisë biologjike me zbatimin e programit Natura 2000, janë caktuar si zona të mbrojtura rreth 12-13% e zonave bujqësore dhe pyjore. Sistemet e aktivitetit fermer me vlera të larta natyrore luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe habitateve, si dhe në mbrojtjen e peizazhit dhe cilësinë e tokës. Në shumicën e Shteteve Anëtare këto sisteme zënë ndërmjet 10-30% të zonave bujqësore. Në disa zona braktisja e aktivitetit fermer mund të shkaktojë dëme të rënda mjedisore.

Prandaj, zonat rurale në vitet e ardhshme përballen me sfida të veçanta në lidhje me rritjen, vendet e punës dhe qëndrueshmërinë. Por, ato paraqesin mundësi të vërteta në lidhje me potencialin e tyre për rritje në sektorë të rinj, për të siguruar komoditete rurale dhe turizëm, si zona tërheqëse dhe vende ku jetohej dhe punohej, dhe rolit të tyre si rezervuar burimesh natyrore dhe peizashesh me vlerë të lartë.

Sektorët bujqësorë dhe ushqimorë duhet të përfitojnë nga mundësitë që u sigurohen nga qëndrimet e reja, teknologjitë dhe novacioni për të plotësuar kërkesën në rritje të tregut, si në Europë ashtu dhe në botë. Mbi të gjitha, investimet në burimin kryesor të kapitalit njerëzor do t'i lejojnë zonat rurale dhe sektorin agroushqimor që të shikojë drejt të ardhmes me besim.

Me rastin e rinisjes së strategjisë së Lisbonës, Këshilli European ka ripohuar që strategjia e Lisbonës duhet të shikohet në kuptimin më të gjerë të kërkesës për zhvillim të qëndrueshëm, që nevojat e tanishme duhet të plotësohen pa cenuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre [4]. Periudha e re e programimit paraqet një mundësi unike për të ripërqendruar mbështetjen nga FBEZHR-ja e re për rritjen, vendet e punës dhe qëndrueshmërinë. Në këtë drejtim, ajo është plotësisht në linjë me Deklaratën për Parimet Orientuese për Zhvillimin e Qëndrueshëm [5] dhe me Programin e ri të Veprimit të Lisbonës që ka për qëllim të përqendrojë vëmendjen në burime të caktuara për ta bërë Europën një vend më tërheqës ku të investohet dhe punohet, duke promovuar njohuritë dhe novacionin për rritje dhe krijimin e vendeve më të mira dhe më cilësore të punës.

Politika e zhvillimit rural duhet të ndihmojë zonat rurale për të arritur këto objektiva në periudhën 2007-2013. Kjo kërkon një qëndrim më strategjik në lidhje me konkurrueshmërinë, krijimin e vendeve të punës dhe novacionin në zonat rurale si dhe qeverisje të përmirësuar në realizimin e programeve. Duhet t'i jepet rëndësi në rritje investimeve afatgjata në njerëz, ekspertizë dhe kapital në sektorët e aktivitetit fermer dhe pyjeve, mënyrave të reja për të siguruar shërbime mjedisore fitim-fitim, dhe krijimit të vendeve më të mira dhe më cilësore të punës nëpërmjet diversifikimit, në veçanti për gratë dhe të rinjtë. Duke ndihmuar zonat rurale të BE-së të arrijnë potencialin e tyre si zona tërheqëse ku investohet, punohet dhe jetohet, politika e zhvillimit rural mund të luajë rolin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të Europës.

3. Përcaktimi i prioritetëve të Komunitetit për periudhën e programimit të zhvillimit rural 2007-2013.

Brenda kuadrit të objektivave të parashikuara në Rregulloren (KE) nr. 1698/2005, orientimet strategjike të përcaktuara më poshtë caktojnë prioritetet e Komunitetit në përputhje me nenin 9 të saj. Orientimet kanë për qëllim integrimin e prioritetëve politike kryesore si shprehet në përfundimet e Këshillave Europeanë të Lisbonës dhe Göteborgut. Për çdo grup prioritetesh, parashtrihen veprime kryesore si shembuj. Në bazë të këtyre orientimeve strategjike, çdo Shtet Anëtar do të përgatisë planin e tij kombëtar strategjik si kuadri referues për përgatitjen e programeve të zhvillimit rural.

Burimet që i caktohen prioritetëve komunitare për zhvillimin rural (brenda kufijve minimale rregullatore të fondeve për çdo bosht) do të varen nga situata specifike, pikat e forta, dobësitë dhe mundësitë e çdo fushe programi. Secili prioritet komunitar dhe kontributi i tyre për objektivat e Lisbonës dhe Göteborgut, duhet të reflektohet në nivel Shteti Anëtar në planin kombëtar strategjik dhe programet e zhvillimit rural. Në shumë raste, do të ketë prioritetet kombëtare ose rajonale për probleme specifike që lidhen me zinxhirin agror ushqimor ose situatën mjedisore, klimatike dhe gjeografike të bujqësisë dhe pyjeve. Zonat rurale mund të përballen me çështje të tjera specifike si presioni i zonave periurbane, papunësia, largësia dhe dendësia e ulët e popullsisë.

3.1. Përmirësimi i konkurrueshmërisë në sektorin e bujqësisë dhe të pyjeve Orientimet strategjike komunitare

Sektorët europeanë të bujqësisë, pyjeve dhe përpunimit të ushqimeve kanë potencial të madh për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve me cilësi të lartë dhe vlerë të shtuar, që plotëson kërkesën e shumëllojshme në rritje të konsumatorëve europeanë dhe tregjeve botërore.

Burimet që i caktohen boshtit 1 duhet të kontribuojnë për një sektor european agror ushqimor të zhvilluar dhe dinamik, duke u përqendruar në prioritetet e transferimit të njohurive, modernizimit, novacionit dhe cilësisë në zinxhirin ushqimor, dhe sektorët prioritar për investime në kapital fizik dhe njerëzor.

Në mënyrë që të arrihen këto prioritetet, Shtetet Anëtare inkurajohen të përqendrojnë mbështetjen për veprime kryesore. Veprime kryesore të tilla përfshijnë:

- (i) ristrukturimin dhe modernizimin e sektorit të bujqësisë që vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shumë zonave ruarale, veçanërisht në Shtetet e reja Anëtare. Rregullimi i suksesshëm i bujqësisë është çelësi i zhvillimit të konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë mjedisore të sektorit të bujqësisë, dhe rritjes së numrit të vendeve të punës dhe zhvillimit në fushat e ekonomisë të lidhura me këto. Këtu përfshihet promovimi dhe pritja e ndryshimit brenda sektorit të bujqësisë në drejtim të ristrukturimit dhe modernizimit, dhe zhvillimit të një qëndrimi proaktiv në trajnimin dhe ritrajnimin e bujqve, veçanërisht në lidhje me aftësitë e transferueshme;
- (ii) përmirësimin e integritit në zinxhirin agrorshqimor. Industria europiane ushqimore është një nga industritë më konkurruese dhe novatore, por po përballet me konkurrencë globale në rritje. Fusha e veprimt të ekonomisë ruarale është e konsiderueshme për të krijuar dhe tregtuar produkte të reja, për të ruajtur më shumë vlera në zonat rurale nëpërmjet skemave të cilësisë, dhe për të promovuar paraqitjen e produkteve europiane jashtë Europës. Përdorimi i shërbimeve këshillimore dhe të mbështetjes për të plotësuar standardet e Komunitetit do të kontribuojë në këtë proces integrimi. Një sektor i bujqësisë me orientim nga tregu do të ndihmojë që të konsolidohet më tej qëndrimi i sektorit agrorshqimor të Europës si një punëdhënës i rëndësishëm dhe burim rritjeje ekonomike;
- (iii) mundësimin e novacionit dhe aksesin në kërkim dhe zhvillim (K dhe ZH). Novacioni ka një rëndësi në rritje për sektorët europianë të aktivitetit fermer, agrorshqimorë dhe të pyjeve. Ndërkohë që shoqëritë tregtare europiane agrorshqimore janë shpesh në pararojë të tendencave të fundit, futja e produkteve dhe proceseve të reja mund të kontribuojë ndjeshëm në rendimentin e përpunuesve dhe bizneseve bujqësore më të vogla. Në veçanti, forma të reja bashkëpunimi mundësojnë aksesin në kërkim dhe zhvillim, novacionin dhe veprimet e ndërmarra sipas Programit të Shtatë Kuadër [6];
- (iv) inkurajimin e asimilimit dhe përhapjes së teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK). Sektori agrorshqimor në tërësi identifikohet si i mangët në asimilimin e teknologjive TIK. Kjo vlen veçanërisht për bizneset e vogla. Miratimi i aplikimeve të biznesit elektronik vazhdon të jetë në një nivel të ulët jashtë shumëkombësheve të mëdha dhe furnizuesit e tyre, të mëdhenj. Fondet e zhvillimit rural duhet të plotësojnë nisma të ardhshme të Komisionit si i 2010 në fushat e biznesit elektronik (veçanërisht në lidhje me sipërmarrjet e vogla dhe të mesme), aftësive elektronike dhe nxënies elektronike;
- (v) nxitjen e sipërmarrjeve dinamike. Reformat e fundit kanë krijuar një mjedis me orientim nga tregu për aktivitetin fermer europian. Kjo sjell mundësi të reja për bizneset bujqësore. Por shfrytëzimi i këtij potenciali ekonomik do të varet nga zhvillimi i aftësive strategjike dhe organizative. Inkurajimi i përfshirjes së bujqve të rinj në profesion mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim;
- (vi) zhvillimin e pikave të reja të tregtimit për produktet bujqësore dhe pyjore. Pika të reja të tregtimit mund të ofrojnë një vlerë të shtuar më të lartë, në veçanti për produktet cilësore. Mbështetja për investime dhe trajnim në fushën e prodhimit joushqimor, sipas zhvillimit rural, mund të plotësojë masa të marra sipas shtyllës së parë duke krijuar pika të reja dhe novatore për prodhim, ose për të ndihmuar zhvillimin e materialeve të prodhuara me anë të energjisë së ripërtëritshme, biokarburanteve dhe kapaciteteve përpunuese;
- (vii) përmirësimin e rendimentit mjedisor të bujqësisë dhe pyjeve. Qëndrueshmëria afatgjatë do të varet nga aftësia për të prodhuar produkte që konsumatorët dëshirojnë të blejnë, ndërsa arrihen standarde të larta mjedisore. Investimet për rendiment mjedisor të lartë mund të çojnë gjithashtu në rritje efikasiteti në prodhim, duke krijuar një situatë fitim-fitim.

Për të rritur ripërtëritjen brez pas brezi të bujqësisë, mund të konsiderohen kombinime të masave të disponueshme sipas boshtit 1, të përshtatura sipas nevojave të bujqve të rinj.

3.2. Përmirësimi i mjedisit dhe peizazhit Orientimet strategjike komunitare

Për të mbrojtur dhe rritur vlerën e burimeve natyrore dhe peizazheve të zonave rurale të BE-së, burimet që i janë caktuar boshtit 2 duhet të kontribuojnë për tri zona prioritare në nivel BE-je: shumëllojshmëria biologjike dhe ruajtja, dhe zhvillimi i sistemeve të aktivitetit fermer, dhe pyjeve me vlera të larta natyrore dhe peizazheve tradicionale bujqësore; uji; dhe ndryshimet klimatike.

Masat e disponueshme sipas boshtit 2 duhet të përdoren për të integruar këto objektiva mjedisore dhe për të kontribuar në zbatimin e rrejtit Natura 2000 për bujqësinë dhe pyjet, në angazhimet e Göteborgut për të ndaluar keqësimin e shumëllojshmërisë biologjike deri në vitin 2010, në objektivat e parashikuara në Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit dhe Këshillit, datë 23 tetor 2000, që përcakton kuadrin për veprimet komunitare në fushën e politikave të ujit [7] dhe objektivat e Protokollit të Kiotos për lehtësimin e ndryshimeve klimatike.

Në mënyrë që të arrihen këto prioritete, Shtetet Anëtare inkurajohen për të përqendruar mbështetjen e veprimeve kryesore. Veprime kryesore të tilla përfshijnë:

(i) promovimin e shërbimeve mjedisore dhe praktikave të aktivitetit fermer, miqësore ndaj kafshëve. Qytetarët europianë presin që bujqit të respektojnë standardet e detyrueshme. Por shumë të tjerë janë dakord që bujqit duhet të shpërblehen për angazhimet të cilat ndërrmarin në vazhdim, shpërndarjen e shërbimeve të cilat tregu nuk mund t'i sigurojë vetëm, në veçanti kur përqendrohen në burime specifike të një rëndësie të veçantë në drejtimin e bujqësisë dhe pyjeve, si uji dhe toka;

(ii) mbrojtjen e peizazhit bujqësor dhe pyjeve. Në Europë, shumë nga mjedisi rural me vlerë është produkt i bujqësisë. Praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të tokës mund të ndihmojnë në uljen e rrezikut që lidhet me braktisjen, shkretimin dhe zjarret në pyje, në veçanti në zonat më pak të favorshme. Sistemet e përshtatshme të aktivitetit fermer ndihmojnë në ruajtjen e peizazhit dhe habitateve, që variojnë nga zonat e lagëta te livadhet dhe kullotat malore. Në shumë zona, kjo është një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe e tërheqjes së përgjithshme të zonave rurale si vende për të punuar dhe për të jetuar;

(iii) luftën kundër ndryshimeve klimatike. Bujqësia dhe pyjet janë në qendër të zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme dhe burimeve materiale për impiantet bioenergjetike. Praktikave të përshtatshme të bujqësisë dhe pyjeve mund të kontribuojnë në uljen e emetimeve të gazit serë, dhe ruajtjes së efektit të karbonit dhe lëndëve organike në përbërjen e tokës, dhe mund të ndihmojnë gjithashtu në përshtatjen me impaktet e ndryshimit klimatik;

(iv) konsolidimin e kontributit të aktivitetit fermer organik. Aktiviteti fermer organik përfaqëson një qëndrim tërësor të bujqësisë së qëndrueshme. Në lidhje me këtë, kontributi i saj në objektivat mjedisore dhe të mirëqenies së kafshëve mund të përforcohet më tej;

(v) inkurajimin e nismave (fitim-fitim) mjedisore dhe ekonomike. Përgatitja e qëllimeve mjedisore, në mënyrë të veçantë nëpërmjet masave agromjedisore, mund të kontribuojë në identifikimin e zonave rurale dhe në produktet e tyre ushqimore. Ato mund të formojnë një bazë për rritje dhe vende pune nëpërmjet turizmit dhe sigurimit të komoditeteve, në veçanti kur lidhen me diversifikimin në turizëm, artizanatin, trajnimin ose sektorin joushqimor;

(vi) promovimi i ekuilibrit territorial. Programet e zhvillimit rural mund të japin një kontribut jetësor për tërheqjen e zonave rurale. Ato mund të sigurojnë ruajtjen e një ekuilibri të qëndrueshëm ndërmjet zonave urbane dhe rurale në një ekonomi konkurruese, dhe të bazuar në nohuri. Bashkërisht me boshtet e tjera të programeve, masat e menaxhimit të tokës mund të japin një kontribut pozitiv në shpërndarjen e hapësirës së aktiviteteve ekonomike dhe kohezionit territorial

3.3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale dhe inkurajimi i diversifikimit të ekonomisë rurale Orientimet strategjike komunitare

Burimet që i caktohen fushave të diversifikimit të ekonomisë rurale dhe cilësisë së jetës në zonat rurale, sipas boshtit 3, duhet të kontribuojnë në prioritetin gjithëpërfshirës të krijimit të mundësive të punësimit dhe kushteve për rritje. Gama e masave të disponueshme sipas boshtit 3 duhet të përdoret, në veçanti, për të promovuar ndërtimin e kapaciteteve, fitimin e aftësive dhe organizimin e strategjive lokale të zhvillimit, dhe gjithashtu për të siguruar që zonat rurale të vazhdojnë të jenë tërheqëse për brezat e ardhshëm. Gjatë promovimit të trajnimit, informacionit dhe sipërmarrjeve, duhet të merren parasysh nevojat e veçanta të grave, të rinjve dhe punonjësve në moshë.

Në mënyrë që të arrihen këto prioritete, Shtetet Anëtare inkurajohen për të përqendruar mbështetjen e veprimeve kryesore. Veprime kryesore të tilla përfshijnë:

(i) rritjen e aktiviteteve ekonomike dhe përqindjes së punësimit në ekonominë e gjerë rurale. Diversifikimi është i nevojshëm për rritjen, punësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale dhe, në këtë mënyrë, kontribuon në një ekuilibër territorial më të mirë si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social. Turizmi, artizanati dhe sigurimi i komoditeteve rurale janë sektorë me rritje në shumë rajone dhe paraqesin mundësi si për diversifikimin në fermë jashtë bujqësisë, ashtu edhe për zhvillimin e mikrobizneseve në ekonominë e gjerë rurale;

(ii) inkurajimin e përfshirjes së grave në tregun e punës. Në shumë zona shërbimet e pamjaftueshme të kujdesit të fëmijëve krijojnë pengesa specifike. Nismat lokale për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit të fëmijëve mund të lehtësojnë aksesin në tregun e punës. Kjo përfshin zhvillimin e infrastrukturës së kujdesit të fëmijëve, mundësisht bashkërisht me nismat e inkurajimit të krijimit të bizneseve të vogla që lidhen me aktivitetet rurale dhe shërbimeve lokale;

(iii) rikthimin e shpirtit të fshatit. Nismat e integruara që bashkojnë diversifikimin, krijimin e bizneseve, investimet e trashëgimisë kulturore, infrastrukturën për shërbimet lokale dhe rinovimin mund të kontribuojnë në përmirësimin si të premisave ekonomike ashtu edhe të cilësisë së jetës;

(iv) zhvillimin e mikrobizneseve dhe artizanatit që mund të përmirësojë aftësitë tradicionale ose të shtojë kompetenca të reja, veçanërisht kur bashkohet me blerjen e pajisjeve, trajnimin dhe stërvitjen, në këtë mënyrë duke ndihmuar promovimin e sipërmarrjeve dhe zhvillimin e strukturës së ekonomisë;

(v) trajnimin e të rinjve në zhvillimin e aftësive të nevojshme për diversifikimin e ekonomisë, që mund të krijojë më tej lidhje me kërkesën për turizëm, argëtimin, shërbimet mjedisore, praktikat rurale tradicionale dhe produktet cilësore;

(vi) inkurajimin e asimilimit dhe shpërndarjes së TIK-së. Asimilimi dhe shpërndarja e TIK-së në zonat rurale është thelbësore për diversifikimin, si dhe për zhvillimin lokal, sigurimin e shërbimeve lokale dhe promovimin e përfshirjes elektronike. Ekonomitë e shkallës mund të arrihen nëpërmjet nismave TIK në fshatra që bashkojnë pasjiset e TI-së, rrjetëzimin dhe trajnimin e aftësive elektronike nëpërmjet strukturave komunitare. Nisma të tilla mund të lehtësojnë ndjeshëm asimilimin e TI-së nga fermat lokale dhe bizneset rurale, dhe miratimin e biznesit elektronik dhe tregtisë elektronike. Duhet shfrytëzuar plotësisht avantazhet e mundësive që sigurojnë interneti dhe komunikimet e shpejta, të mbështetura, për shembull, nga programet rajonale sipas Fondeve Strukturore, për të tejkaluar pengesat e vendndodhjes;

(vii) zhvillimin e sigurimit dhe përdorimit novator të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, të cilat mund të kontribuojnë në krijimin e pikave të reja të prodhimit të produkteve bujqësore dhe pyjore, sigurimin e shërbimeve lokale dhe diversifikimin e ekonomisë rurale;

(viii) inkurajimin e zhvillimit të turizmit. Turizmi është një sektor kryesor rritjeje në shumë zona rurale dhe bazohet në trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Përdorimi në rritje i TIK-së në turizëm për rezervime, promovim, marketing, hartimin e shërbimeve dhe aktivitete argëtuese mund të përmirësojë numrin e turistëve dhe kohëzgjatjet e qëndrimit, veçanërisht në rastet kur kjo siguron lidhje me biznese më të vogla dhe inkurajon agroturizmin;

(ix) përmirësimin e infrastrukturës lokale, veçanërisht në Shtetet e reja Anëtare. Investime të rëndësishme do të ndërmerren në zhvillime kryesore të infrastrukturës së telekomunikacioneve, transportit, energjetikës dhe ujit, në vitet në vazhdim. Mbështetje e konsiderueshme do të jetë e disponueshme nga Fondet Strukturore, duke variuar nga rrjetet transeuropiane në zhvillimin e lidhjeve me bizneset ose parqet shkencore. Në mënyrë që efekti shumëfishues të realizohet plotësisht, në aspektin e vendeve të punës dhe rritjes, infrastrukturës së vogël lokale, programet e zhvillimit rural me mbështetje të brendshme, mund të luajnë një rol jetësor në lidhjen e këtyre investimeve kryesore me strategjitë lokale për diversifikimin dhe zhvillimin e potencialit të sektorëve bujqësorë dhe ushqimorë.

3.4. Ndërtimi i kapaciteteve lokale për punësim dhe diversifikim Orientimet strategjike komunitare

Burimet që i caktohen boshtit 4 ("Lideri") duhet të kontribuojnë në prioritetet e boshteve 1 dhe 2, dhe në veçanti të boshtit 3, por luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në prioritetet horizontale të përmirësimit të qeverisjes dhe mobilizimit të potencialit të zhvillimit të brendshëm të zonave rurale.

Mbështetja sipas boshtit 4 siguron mundësinë, në drejtim të një strategjie lokale zhvillimi të drejtuar nga Komuniteti, që bazohet në nevojat dhe pikat e forta lokale, për të bashkuar të tre objektivat — konkurrueshmërinë, mjedisin dhe cilësinë e jetës/diversifikimin. Qëndrimet e integruara që përfshijnë bujqit, pylltarët dhe aktorët e tjerë ruralë ruajnë dhe përmirësojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore lokale, rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe investojnë në/ dhe promovojnë specialitetet, turizmin dhe burime të ripërtëritshme dhe energjetike.

Në mënyrë që të arrihen këto prioritete, Shtetet Anëtare inkurajohen për të përqendruar mbështetjen e veprimeve kryesore. Veprime kryesore të tilla përfshijnë:

- (i) ndërtimin e kapaciteteve të bashkëpunimit lokal, aktivizimin dhe promovimin e fitimit të aftësive që ndihmojnë në mobilizimin e potencialit lokal;
- (ii) promovimin e partneritetit privat-publik. Në veçanti, "Lideri" do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në inkurajimin e qëndrimeve novatore për zhvillimin rural dhe afrimin e sektorëve privatë dhe publikë me njëri-tjetrin;
- (iii) promovimin e bashkëpunimit dhe novacionit. Nismat lokale si "Lideri" dhe mbështetja për diversifikimin mund të luajë një rol thelbësor në lidhjen e njerëzve me ide dhe qëndrime të reja, inkurajimin e novacionit dhe sipërmarrjeve dhe mund të promovojë përfshirjen dhe sigurimin e shërbimeve lokale. Komunitetet në linjë mund të ndihmojnë në përhapjen e njohurive, shkëmbimin e praktikave të mira dhe inovacionit në produktet dhe shërbimet rurale;
- (iv) përmirësimi i qeverisjes lokale. "Lideri" mund të ndihmojë nxitjen e qëndrimeve novatore që lidhin bujqësinë, pyjet dhe ekonominë lokale, në këtë mënyrë ndihmon diversifikimin e bazës ekonomike dhe forcimin e strukturës shoqërore-ekonomike të zonave rurale.

3.5. Sigurimi i qëndrueshmërisë së programimit Orientimet strategjike komunitare

Gjatë përgatitjes së strategjive të tyre kombëtare, Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që të shfrytëzohen maksimalisht sinergjitë ndërmjet dhe brenda boshteve dhe të shmangen mospërputhjet. Ku është e nevojshme, ato mund të zhvillojnë qëndrime të integruara. Ato do të duan gjithashtu të reflektojnë si të marrin parasysh strategji të tjera në nivel BE-je, si Plani i Veprimit për Ushqimet dhe Aktivitetet Fermere Organike, angazhimin për përdorimin në rritje të burimeve të energjisë së ripërtëritshme [8], nevojën për të zhvilluar një strategji afatmesme dhe afatgjatë të BE-së për të luftuar ndryshimet klimatike [9], dhe nevojën për të parashikuar efektet e mundshme në aktivitetet fermere dhe pyjet, Strategjinë e BE-së për pyjet dhe Plani i Veprimit (që mund të ndihmojë arritjen si të objektivave të rritjes dhe punësimit ashtu edhe të qëndrueshmërisë) dhe prioritetet e përcaktuara në Programin e Gjashtë për Veprim Mjedisor Komunitar parashikuar në Vendimin nr. 1600/2002/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit [10], veçanërisht ato prioritete të identifikuara që kërkojnë strategji mjedisore tematike (mbrojtja e tokës, mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit ujor, përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve, ndotja e ajrit, mjedisi urban, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe riciklimi i mbetjeve).

Ekzistojnë disa mënyra të disponueshme në nivel BE-je dhe Shteti Anëtar për të përmirësuar qeverisjen dhe zbatimin e politikave. Mund të përdoret asistencë teknike për të ndërtuar rrjete kombëtare dhe europiane për zhvillim rural, si platformë për shkëmbimin e praktikave të mira dhe ekspertizës në të gjitha aspektet e hartimit, menaxhimit dhe zbatimit të politikave, ndërmjet grupeve të interesuara. Duhet të konsiderohet informacioni dhe

reklamimi për të siguruar përfshirjen e herët të aktorëve të ndryshëm në përgatitjen e strategjive kombëtare dhe shfrytëzohet ky informacion dhe reklamim për hapat e mëvonshme të zbatimit.

3.6. Plotësueshmëria ndërmjet instrumenteve komunitare Orientimet strategjike komunitare

Duhet të inkurajohet sinergjia ndërmjet politikave të zhvillimit strukturor të punësimit dhe rural. Në këtë drejtim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë plotësueshmërinë dhe koherencën ndërmjet veprimeve për financim nga Fondi European i Zhvillimit Rajonal, Fondi i Kohezionit, Fondi Social European, Fondi European i Peshkimit dhe FBEZHR-ja për një territor të dhënë dhe një fushë të caktuar aktiviteti. Parimi kryesor orientues, në lidhje me vijën e demarkimit dhe mekanizmat koordinuese ndërmjet veprimeve të mbështetura nga fondet e ndryshme, duhet të përcaktohet në kuadrin referues të strategjisë kombëtare dhe planin kombëtar strategjik.

Për investimet në infrastrukturë, shkalla e ndërhyrjes mund të merret si një parim orientues. Për shembull, për investimet në transport dhe infrastrukturë tjetër në nivel Shteti Anëtar, rajonal ose nënrajonal, përdoren instrumente të politikës së kohezionit, ndërsa në nivel lokal mund të përdoren masa e shërbimeve bazë sipas boshtit 3, duke siguruar lidhjen ndërmjet niveleve lokale dhe rajonale.

Në lidhje me zhvillimin e kapitalit njerëzor, mbështetja sipas zhvillimit rural do të përqendrohet tek fermerët dhe aktorët ekonomikë të përfshirë në diversifikimin e ekonomisë rurale. Popullsia e zonave rurale mund të përfitojë mbështetje si pjesë e një qëndrimi të integruar nga poshtë lart. Veprimet në këto fusha duhet të zbatohet në përputhje të plotë me objektivat e Strategjisë Europiane të Punësimit, si përcaktohet në orientimet e integruara për rritje dhe vende pune, dhe në koherencë me veprimet e ndërmarra sipas programeve të reformave kombëtare në kuadër të procesit të Lisbonës. Programi i punës për Arsim dhe Trajnim i vitit 2010 ka për qëllim të arrijë anën e arsimit dhe trajnimit të qëllimeve të Lisbonës. Nxënia për gjithë jetën është në thelb të këtij programi dhe zbatohet në të gjitha nivelet dhe për të gjithë tipat e arsimit dhe trajnimit, duke përfshirë sektorët bujqësorë, pyjorë dhe agroushqimorë.

4. Sistemi i raportimit

Rregullorja (KE) nr. 1698/2005 parashikon monitorimin strategjik të Komunitetit dhe strategjive kombëtare. Baza për raportimin e përparimit do të jetë kuadri i përbashkët për monitorim dhe vlerësim, që do të vendoset në bashkëpunim me Shtetet Anëtare.

Kuadri parashikon një numër të kufizuar treguesish të përbashkët dhe një metodologji të përbashkët. Ky kuadër do të plotësohet nga tregues të veçantë sipas programeve dhe do të reflektojë karakterin e çdo fushe programi.

Një grup i përbashkët treguesish do të lejojë mbledhjen e produkteve, rezultateve dhe impakteve në nivel BE-je dhe do të ndihmojë në vlerësimin e përparimit në arritjen e prioriteteve të Komunitetit. Treguesit bazë të përcaktuar në fillim të periudhës së programimit do të lejojnë vlerësimin e situatës fillestare dhe formojnë bazën për zhvillimin e strategjisë së programit.

Aktivitetet e vlerësimit do të realizohen vazhdimisht, duke përfshirë vlerësime në fillim të programit, në mes të tij dhe në përfundim, si dhe aktivitete të tjera vlerësuese që konsiderohen të dobishme për përmirësimin, menaxhimin dhe impaktin e programit. Këto do të shoqërohen nga studime tematike dhe vlerësime sintezash në nivel komunitar, si dhe nga aktivitete të rrjetit european për zhvillim rural si platformë shkëmbimi dhe ndërtimi kapacitetesh për vlerësim në Shtetet Anëtare. Shkëmbimi i praktikave të mira dhe ndarja e rezultateve të vlerësimit mund të kontribuojë ndjeshëm në efektshmërinë e zhvillimit rural. Në këtë drejtim, rrjeti european duhet të luajë një rol qendror në mundësimin e kontakteve.

- [1] Përfundimet e presidencës së KE-së të Luxemburgut (12 dhe 13 dhjetor 1997), Berlinit (24 dhe 25 mars 1999) dhe Brukselit (24 dhe 25 tetor 2002)
- [2] Përkufizimi i OBEZH-it bazohet në popullsinë që jeton në komunat rurale (p.sh. më pak se 150 banor për km²), në një rajon të dhënë NNJST III. Shiko Vlerësimin e Zgjeruar të Impaktit – SEC (2004) 931. Ky është përkufizimi i vetëm i njohur ndërkombëtarisht për zonat rurale. Sidoqoftë, në disa raste, ky përkufizim nuk merr në konsideratë plotësisht popullsinë që jeton në zona rurale me dendësi më të madhe, veçanërisht në zona periferike urbane. Sipas kuptimit të orientimeve të dhëna, përdoret vetëm për qëllime statistikore dhe përshkruese.
- [3] Siç matet nga PBB-ja sipas paritetit të fuqisë blerëse.
- [4] Përfundimet e presidencës së KE-së të Brukselit (22 dhe 23 Mars 2005).
- [5] Përfundimet e presidencës së KE-së të Brukselit (16 dhe 17 Qeshor 2005).
- [6] Puna e Komisionit të Përhershëm për Kërkime Bujqësore duhet të merret parasysh gjithashtu në këtë drejtim.
- [7] GZ L 327, 22.12.2000, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva nr. 2455/2001/KE (GZ L 331, 15.12.2001, fq. 1).
- [8] Përfundimet e presidencës së Këshillit Europian të Brukselit (25 dhe 26 mars 2004).
- [9] Përfundimet e presidencës së Këshillit Europian të Brukselit (22 dhe 23 mars 2005).
- [10] GZ L 242, 10.09.2002, fq. 1.